



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-039

Prishtinë, më 11 nëntor 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 4 NËNTOR 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati, dhe Sllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Ardian Gjini, Lutfi Haziri dhe Myfera Sinik, ndërsa munguan Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi.

Nga NDI: Rinor Beka dhe

Nga OSBE: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës dhe me pikat shtesë, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 nëntor 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
 - 2.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare,
 - 2.2 Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ngrohjen qendrore, nr. 03/L-049
 - 2.3 Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për procedurën jokontesimore, nr.03/L-007,
 - 2.4 Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për avokatinë, nr. 02/L-040,
 - 2.5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspeksionin bujqësor,
 - 2.6 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim, dhe
 - 2.7 Shqyrtimi i Raportit për gjendjen mjedisore.
3. Shqyrtimi i Planit strategjik i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pikat shtesë:

1. Shqyrtimi i Rekomandimit Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
2. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2009.
4. Kërkesa e Grupit parlamentar të AAK-së për të ftuar në interpelancë Kryeministrin,
5. Kërkesa e tetë (8) deputetëve dhe e deputeti Riza Smaka, i përkrahur nga pesë(5) deputet të tjerë për radhitje në seancë plenare të situatës në Trustin Pensional të Kosovës,
6. Njoftim i Grupit Parlamentar të PDK-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
7. Të ndryshme - Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimit jashtë vendit.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 nëntor 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 nëntor 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën plenare të radhës.

Kryetari propozoi që seanca plenare e radhës të mbahet më 20 nëntor 2008.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 20 nëntor 2008, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ngrohjen qendrore, nr. 03/L-049,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për procedurën jokontesimore, nr.03/L-007,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për avokatinë, nr. 02/L- 040,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspeksionin bujqësor,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm,
11. Shqyrtimi i Raportit lidhur më gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007 dhe
12. Njoftim i Grupit Parlamentar të PDK-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kryesia, me propozim të anëtarit të Kryesisë, z. Naim Maloku, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare më 21 nëntor 2008, të ketë vetëm një pikë të rendi të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2009.

3. Shqyrtimi i Planit strategjik të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi Planin strategjik të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Plani strategjik i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës u dërgohet grupeve parlamentare për shqyrtim.
2. Vërejtjet dhe sugjerimet e grupeve parlamentare i dërgohen Kryesisë së Kuvendit.

4. Kërkesa e Grupit parlamentar të AAK-së për të ftuar në interpelancë Kryeministrin e Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi Kërkesën e Grupit Parlamentar të AAK-së për ta ftuar në Interpelancë Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkesa e Grupit Parlamentar të AAK-së për ta ftuar në Interpelancë Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi, i dërgohet Kryeministrit të Kosovës që ta shqyrtojë atë brenda shtatë ditësh, në përputhje me Rregullën 25 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

5. Kërkesa e tetë (8) deputetëve dhe e deputeti Riza Smaka, i përkrahur nga pesë(5) deputetë Të tjerë, për radhitje në seancë plenare të situatës në Trustin Pensional të Kosovës

Kryesia, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që të përgatit një Informatë për deputetët e Kuvendit lidhur më gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
2. Informata për deputetët e Kuvendit të jetë e gatshme para seancës plenare të 20 nëntorit 2008.

6. Të ndryshme - Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimit jashtë vendit

Sabri Hamiti, në emër të Komisionit për Punë të Jashtme i njoftoi anëtarët e Kryesisë me kërkesat e deputetëve për udhëtim jashtë vendit.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesat për udhëtim jashtë vendit, mori këto

V E N D I M E

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme (gjashtë anëtarë të Komisionit dhe një zyrtar nga stafi mbështetës i Komisionit), në Shqipëri, më 26 dhe 27 nëntor 2008.
2. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes Myzejene Selmani, kryetare e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion., në Londër, prej 1-3 dhjetor 2008.
3. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetit Arsim Rexhepi në Gjermani, prej 16-20 nëntor 2008.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale